1.2. Nëse kërkesa për kon-igjim nuk e ndryshon kuptimin dhe përmbajtjen e emrit personal,

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR KORRIGJIMIN E EMRIT PERSONAL NË REGJISTRAT E GJENDJES CIVILE

1.1. Kërkesën e plotësuar (shih shtojcën 3 dhe 4);

1.2. Dokumentin e identifikimit;

1.3. Certifikatën e lindjes;
1.4. Ekstraktin nga regjistri qendror I gjendjes civile;
1.5. Vërtetimin nga arkiva;
1.6. Kopjen e regjistrit fizik (nëse ka gabime në regjistrin e martesës dhe vdekjes);
1.7. Dokument tjetër që provon gabimin material.

NJOHJA DHE ZBÂTIMII VENDIMEVE TE LËSHUARA NÉ SHTETET TJERA PER NDËRRIMINE EMRIT PERSONAL SHTETASIT KOSOVAR

1. Shtetasi kosovar i cili ka një vendim për ndryshimin e emrit personal i nxjerrë nga shteti i huaj, mund të bëj kërkesë për njohjen e atij vendimi ne Zyrën e Gjendjes Civile ku e ka vendbanimin.
2. Vendimi i shtetit të huaj duhet të jetë i përkthyer në njërën .nga gJL1hët zyrtare të Republikës së Kosovës.
3. Shtetasi kosovar përveç vendimit të shtetit të huaj, duhet të sjellë edhe vërtetimin nga Policia e Kosovës për të kaluarën kriminale dhe dokumentin nga gjykata që nuk është nën hetime si dhe duhet t'a sjell dokumentin e identifikimit të shtetit të huaj (pasaportë apo dokument identifikimi që dëshmon qëndrilmn e tij/saj lisishëm në shtetin përkatës).
4. Komisioni i Zyrës së Gjendjes Civile përmes postës elektronike i përcjell Komisionit të themeluar nga Ministri për verifikimin e kërkesave për ndërrim të emrit personal të gjithë dokumentacionin nga paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij nenia
5. Komisionl i themeluar nga Ministri i Punëve të Brendshme për verifikimin e kërke-save për ndërrim të emrit personal e verifikon përmes komunikimit të saj të giithë dokumentacionin në bazat e të dhënave të ARC-së,
6. Komisioni i themeluar nga Ministri i Punëve të Brendshme për verifikimin e kërke-save për ndërrim të emrit personal i kthen përgilåie në Komisionin e Zyrës përkatëse të Gjendjes Civile përmes postës elektronike brenda 15 ditëve të punës.
7. Komisioni i Zyrës së Gjendjes Civile vendos rnbi bazën e përgjigies nga Komisioni i themeluar nga Ministri i Punëve të Brendshme për verifikimin e kërkesave për ndër-rim të emrit personal për njohjen apo refuzimin e vendimit të huaj
8. Nëse Komisioni i Zyrës se Gjendjes Civile vendos për njohjen e vendimit të huaj, dokumentet e palës siç janë: letërnjoftimi, pasaporta dhe patentë shoferi i Republikës së Kosovës me të dhënat e mëhershme, i përcjell tek Komisionet për Shkatëmmin e Dokumenteve në Agiencinë e Regjistrimit Civil.
9. Pala e pakënaqur me vendimin e Komisionit të Zyrës së Gjendjes Civile mund të parashtroj ankesë ne Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave në ARC

Mënyrat e fitimit të shtetësisë

1. Shtetësia e Republikës së Kosovës fitohet:
1.1. me lindje;
1.2. me adoptim;
1.3. me natyralizim;
1.4. në bazë të marrëveshje ndërkombëtare;
1.5. në bazë të neneve 31 dhe 32 të këtij ligii.

Fitimi i shtetësisë me lindje në bazë të origjinës

1. Fëmija lind shtetas i Republikës së Kosovës nëse në kohën e lindjes së Emijës të dy prindërit janë shtetas të Republikës së Kosovës.
2. Nëse në kohën e lindjes së tëmijës vetëm njëri prind e ka shtetësinë e Republikës së Kosovës, tëmija e fiton shtetësinë e Republikës së Kosovës me lindje në rastet vijuese:

2.1. Ernija është i lindur në territorin e Republikës së Kosovës;
2.2. fëmija është i lindur jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe prindi tjetër është me shtetësi të panjohur ose pa shtetësi;
2.3. fëmija është i lindur jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe prindi tjetër ka shtetësi tjetër, por të dy prindërit pajtohen me shkrim që fëmija të fitojë shtetësinë e Republikës së Kosovës, E drejta nga kjo dispozitë duhet të ushtrohet para moshës katërmbëdhjetë vjeçare të fëmijës. Në mungesë të pëlqimit të prindërve femija do të fitojë shtetëslnë e Republikës së Kosovës nëse si pasoj mbetet pa shtetësi.

Fitimi i shtetësisë me lindje në territorin e Republikës së Kosovës

1. Fëmija i lindur ose i gjetur në territorin e Republikës së Kosovës prindërit, e të cilit janë të panjohur ose pa shtetësi e fiton shtetësinë e Republikës së Kosovës me rastin e lindjes, përkatësisht gjetjes.
2. Në rast se të paktën një prind i fëmijës të përcaktuar në paragrafin l. e këtij neni identifikohet para se Emija të ketë mbushur moshën shtatë (7) vjeçare dhe prindi në fjalë nuk është shtetas i Republikës së Kosovës, me kërkesë të prindit fëmija e humb shtetëginë e Republikës së Kosovës, me kusht që me humbjen e shtetësisë së Repub-likës së Kosovës fëmija të mos mbetet pa shtetësi.
3. Fëmija i lindur brenda territorit të Republikës së Kosovës prindërit e të cilit kanë shtetësi tjetër por të cilët kanë leje qëndrimi të përhershëm në Republikën e Kosovës do të fitojë shtetësinë e Republikës së Kosovës me pëlqimin e të dy prindërve.
4. Përjashtimisht nga paragrafi 3. i këtij neni fêtmja i lindur në territorin e Republikës së Kosovës do të fitojë shtetësinë e Republikës së Kosovës nëse si pasoj mbetet pa shtetësi.

Fitimi i shtetësisë me adoptim

Në rast të adoptimit të fëmijës nga prindërit te cilët janë shtetas të Republikës së Kosovës, apo njëri prind është shtetas i Republikës së Kosovës tëmija gëzon të drejtat e fëmijës natyral.

Dispozitai epërgjithshme për natyralizimin e personave të huaj

1. Personi i huaj e fiton shtetësinë e Republikës së Kosovës me natyralizim nëse plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 10, 115 12, 13, 15, 16 dhe 17 të këtij ligji.
2. Natyralizimi bëhet i plotfuqishëm kur personit të natyralizuar i dorëzohet vendimi i plotfuqishëm për fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës i lëshuar nga organi kompetent.
3. Pavarësisht prej plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenet 103 11, 12, 13, 15, 16 ose 17 të këtij ligji, askush nuk mund te fitojë shtetësinë e Repub-likës së Kosovës, nëse është i dënuar për vepër penale brenda ose jashtë

Republikës së Kosovës ose nëse dhënia e shtetësisë është në kundërshtim me interesat e Republikës së Kosovës, në veçanti me ato të sigurisë së brendshme dhe të jashtme ose të mar-rëdhënieve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.

4. Dënimi për vepër penale në kuptimin e paragrafit 3. të këtij neni nuk përfshin:

4.1. Dënimin për vepër penale me giobë ose deri në gjashtë (6) muaj heqje lirie, nëse giykata ka shqiptuar dënimin me kusht▪

4.2. Dënimin për vepër penale të shqiptuar nga një giykatë e huaj nëse vepra në Üalë nuk konsiderohet vepër penale në Republikën e Kosovës ose nëse dënimi është shqip-tuar në bazë të një procedure e Cila nuk është konfoma standar-deve evropiane të së drejtës penale, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore; dhe

4.3. Dënimin për vepër penale të shlyer në mënyrë legjitime nga evidenca e të dënuawe.

5. Organi kompetent e pezullon procedurën e natyralizimlt nëse kundër personit i Cili ka paraqitur kërkesë për natyralizim Janë duke u bërë hetime për vepër penale ose është duke u zhvilluar procedurë giyqësore për vepër penale, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

6. Procedura pezullohet deri në përfundimin e hetimeve, përkatësisht të procedurës GJyqësore,

Natyralizimi i personave të huaj

1. Personi i huaj e fiton shtetësinë e Republikës së Kosovës me kërkesë të tlj nëse në ditën e paraqitjes së kërkesës plotëson kushtet vijuese:

1.1. është i moshës madhore;

1.2. nëse ka qëndruar pa ndërprerë për pesë (5) vjet në Republikën e Kosovës pas marrjes së leje qëndrimit të përhershëm;

1.3. deklarohet dhe me sjelljen e tij głatë qëndrimit në Republikën e Kosovës ka dëshmuar se pranon rendin kushtetues dhe juridik të Republikës së Kosovës dhe se është i integruar nëshoqërinë kosovare përrnes lidhjeve socjale, kulturore, shkencore, ekonomike ose profesionale. Kriteret do të përcaktohen me akte nënligiore të nxjerra nga Ministria e Punëve të Brendshme;

l.4. posedon mjete materiale të mjaftueshme për të giguruar jetesën e vet dhe të personave për mbajtjen e të cilëve është përgjegjës pa shfrytëzuar skemat e asistencës sociale'

1.5. i ka përmbushur të giitha detyrimet financiare ndaj shtetit; dhe

1.6. ai/ ajo dëshmon njohuri elementare në njërën prej gjuhëve zyrtare në shkrłm dhe lexim të Republikës së Kosovës, kulturën dhe rregullimin shoqëror;

2. Qëndrimi në Republikčn e Kosovës pa ndërprerë, słpas paragrafit l, nënparagrafi 1.2. të këtij neni edhe nëse personi qëndron jashtë Republikës së Kosovës për periudha jo rnë të gjata se dhjetë (10) muaj. Për periudha më të giata se dhjetë (10) muaj nevoj itet leja e organit kompetent,

3. Personi i huaj i moshës madhore mund të fitojë shtetësmë e Republikës së Kosovës në bazë të kčrkesës së tij edhe nëse nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1. te këtij neni nëse kjo është në interes të veęantë ekonomik, social, kulturor, sportiv, shkencor, politik apo profesional të Republikës së Kosovës. Fitimi i shtetësisë së Re-publikës së Kosovës sipas këtij neni bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës.

Natyralizimi i bashkëshortit

1. Personi i huaj i cili është bashkëshort i shtetasit te Republikës së Kosovës e fiton shtetësłnë e Republikës së Kosovës në bazë të kërkesës, nëse në ditën e paraqitjes së kërkesës plotëson kushtet vijuese:

1.2. të paktën tre (3) Vite ka lidhje martesore me shtetasin e Republikës së Kosovës;

1.2. është duke jetuar negullisht në Republikën e Kosovës për te paktën një (l) vit dhe posedon leje qëndrim të përkohshëm të lëshuar nga organi kompetent.

1.3. dispozitat nga nënparagrafĉt 1.1, 1.3 , 1.4 dhe 1.6 të paragrafit 1. të nenit 10 të këtij ligji vlejnë po ashtu edhe për natyralizimin e bashkëshortit.

1.4. personi i huaj i ci/l është bashkëshort i shtetasit të Republikës së Kosovës nuk do ta fitojë shtetësinë e Republikës së Kosovës nëse martesa ka ndodhur në kundërshtim me Ligiin mbi Familjen

Natyralizimi i bashkëshortit te personit te natyralizuar

1. Bashkëshorti i personit të natyralizuar e fiton shtetësinë e Republikës së Kosovës nëse në ditën e paraqitjes së kërkesës së tij i plotëson kushtet vijuese:

1.1. nëse të paktën ka tre (3) vite lidhje martesore, pas natyralizimit të bashkëshortit të natyralizuar;

1.2. është duke jetuar rregullisht në Republikën e Kosovës për të paktën dy (2) vite dhe posedon leje të qëndrimi të përkohshëm të lëshuar nga organi kompetent

1.3. dispozitat nga nënparagrafêt 1.1., 1.3. , I .4. dhe 1.6. të paragrafit I. të nenit 10 të këtij ligji vlejnë po ashtu edhe për natyralizimin e bashkëshortit të personit të natyral-izuar.

2. Personi i huaj i cili është bashkëshort i personit të natyralizuar nuk do ta fitojë shtetësinë e Republikës së Kosovës nëse martesa ka ndodhur në kundërshtim me Lig-jin mbi Familjen.

Natyralizimi ifëmijës së mitur tëpersonit të natyralizuar

1. Fëmija i mitur i personit i cili ka paraqitur kërkesën për natyralizim e fiton shtetësinë e Republikës së Kosovës kur prindi i tij e fiton shtetësinë e Republikës së Kosovës edhe nëse fêmlja nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 10 të këtlJ ligJi. Kërkesa për natyralizimin e tèmijës së mitur i bashkëngjitet kërkesës për natyral-izim të parashtruar nga prindi.
2. Për fëmijët mbi moshën katërmbëdhjetë (14) vjeçare deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, pëlqimi paraprak i tij për të fit-uar shtetësinë e Kosovës është i domos-doshëm.
3. Paragrafi I. i këtij neni vlen edhe për personat e mitur të adoptuar.

Lehtësimi i marrjes së shtetësisëpër refugjatët dhe personat pa shtetësi

Organi kompetent duhet sa më shumë të jetë e mundur të lehtësojë natyralizimin e refugiatit dhe personit pa shtetësi. Në veçanti do të bëjë përpjekje të përshpejtojë pro-cedurat e natyralizimit dhe të zvogëlojë sa me shumë të jetë e mundur detyrimet dhe shpenzimet e procedurave të tilla.

Natyralizimi ipersonave me status refugjati osepersonavepa shtetësi

1. Personi me status refugjati ose personi pa shtetësi mund ta fitojë shtetësinë e Republikes Kosovës me natyralizim nëse ai/ajo qëndron në territorin e Repub-

likës së Kosovës pesë (5) vite nga dita e man-jes së statusit të refugjatit ose të personit pa shtetësi.

Të drejtën e fitimit të shtetësisë sipas paragrafit l. të këtij neni e kanë edhe anëtarët e familjes. Për tëmijët mbi moshën katërmbëdhjetë (14) vjeçare deri në moshën tetëm-bëdhjetë (18) vjeçare, pëlqimi paraprak i tij për të fituar shtetësinë e Kosovës është i domosdoshëm.

Dispozitat nga nënparagrafët 1.1. 1.3. dhe 1.6. të paragrafit 1. të nenit 10 të këtij ligii vlejnë po ashtu edhe për fitimin e shtetësisë së personit pa shtetësi Ose personit refugjat, përjashtimisht fèmijëve nga paragrafi 2. i këtij neni
Procedurat dhe kriteret për lehtësimin e fitimit të shtetëslsë së Republikës së Kosovës në bazë të këtij neni, caktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga MPB-ja;

Natyralizimi ipjesëtarit të diasporës të Republikës së Kosovës

1. Pjesëtari i diasporës i Republikës së Kosovës e fiton shtetësinë e Republikës sö Kosovës në bazë të kërkesës së tij edhe nëse nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nënparagrafët nga paragrafi l. i nenit 10 të këtij ligji.
2. Pjesëtar i diasporës i Republikës gë Kosovës konsiderohet çdo person i cili e ka qën-drimin e ligjshëm dhe të n▪egullt jashtë Republikës se Kosovës por i cili dëshmon se ka lmdur në Republikën e Kosovës (lhe se ka lidhje të ngushta familjare dhe ekonomike në Republikën e Kosovës.
3. Pjesëtar i diasporës i Republikës së Kosovës konsiderohet edhe secili person i cili është pasardhës brenda një gienerate i personit të pëlmendur në paragrafin 2. të këtlj neni dhe i cili dëshmon se mban lidhje familjare në Republikën e Kosovës.
4. IQ-iteret për përcaktimin e lidhjes së ngushtë familjare dhe ekonomlke sipas paragrafëve 2. dhe 3. të këtij neni caktohen nga organi kompetent me akt nënligior,

Natyralizimi ipersonit që e ka h umbur shtetësinë e Republikën e Kosovës

1. Personi i cili e ka humbur shtetësmë e Republikës së Kosovës me lirim nga shtetësia mund të rifitoj shtetësinë e Republikës së Kosovës me kërkesë të tij nëse i plotëson kushtet e përcaktuara nga nënparagrafèt 1.3, 1.4 dhe 1.5 të paragrafit 1. të nenit 10 të këtij ligii.
2. Të drejtën e rifitimit të shtetësisë së Kosovës e kanë edhe fëmljët e personit nga paragrafi l. i këtij neni. Për fèmijët mbi moshën katërmbëdhjetë (14) vjeçare deri në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, pëlqimi paraprak i tij për të rifltuar shtetësinë e Kosovës është i domosdoshëm,

Revokimi i vendimitpër natyralizim

1. Organi kompetent e revokon vendimin për natyralizim nëse konstaton se vendimi është nxjerrë në bazë të deklaratës së rrejshme Ose të fakteve të fshehura.
2. Në rastin e natyralizimit sipas nenit 13 të këtij ligji, revokimi i vendimit për natyral-izimin e prindit ka për pasojë edhe revokimin e vendimit për natyralizirnin e fëmijës së mitur përveç nëse si pasojë Êëmija mbetet pa shtetësi.

Mënyrat e humbjes së shtetësisë

1. Shtetësia e Republikës së Kosovës humbet:
1.1. me lirim nga shtetësia;
1.2. me privim të shtetësisë;
1.3. në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare,

Lirimi nga shtetësia

1. Shtetasi i Republikës së Kosovës e humb shtetësinë e Republikës së Kosovës me lirim në bazë të kërkesës s; tij nëse i plotëson kushtet vijuese.
1.1. posedon shtetësinë e një shteti tjetër ose posedon garancionin e lëshuar nga organi kompetent i shtetit tjetër se do të fitojë shtetësinë e shtetit në fjalë;
1.2. i ka përmbushur të gjitha detyrimet financiare ndaj shtetit dhe ndaj personave për ushqimin dhe mbajtjen e të cilëve është përgjegjës sipas ligjit;
1.3. kundër tij nuk janë duke u zhvilluar hetime ose procedura giyqësore për vepër penale dhe nuk është duke vuajtur dënimin;
2. Kërkesa për lirim nga shtetësia refuzohet nëse shtetasi që kërkon lirimin nga shtetë-sia është nëpunës civil, giykatës, prokuror publik, pjesëtar i shërbimit policor ose pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Republikës së Kosovës.
3. Kërkesa mund të refuzohet nëse lirimi nga shtetëgia është në kundërsh-tim me in teresat e Republikës së Kosovës, në veçanti me ato të sigurisë së brendshme dhe të jashtme ose të man▪ëdhënieve ndërkombëtare të Repub-likës së Kosovës.
4. Humbja e shtetësisë së Republikës së Kosovës me lirim bëhet e plotfuqishme në ditën kur organi kompetent ia dorëzon personit që ka kërkuar lirimin nga shtetësia vendimin e plotfuqishëm për humbjen e shtetësisë.

Lirimi nga shtetësia i personave të mitur

1. Fëmija nën moshën katërmbëdhjetë (14) vjeçare e humb shtetësinë e Repub-likës së Kosovës me lirim nëse kJ0 kërkohet nga njëri prind i cili e ka humbur shtetësinë e Republikës së Kosovës me pëlqimin e prindit tjetër, me kusht që fëmija të posedojë shtetësinë e një shteti tjetër ose posedon garancionin e lëshuar nga organi kompetent i shtetit tjetër se do të fitojë shtetësinë e shtetit në fjalë;
2. Paragrafi 1. i këtij neni vlen edhe për personat e mitur të adoptuar.

Revokimi i vendimitpër lirim nga shtetësia

1. Organi kompetent e revokon vendimin për humbjen e shtetësisë me lirim nëse konstaton se vendimi është nxjerrë në bazë të deklaratës së rrejshme ose të fakteve të fshehura.
2. Nëse premtimi për dhënien e shtetësisë nga shteti tjetër nuk është realizuar brenda një (l) viti,

Gargncioni

1. Me kërkesë të shtetasit i cili kërkon lirimin nga shtetësia, organi kompetent ia lëshon shtetasit në fjalë, një garancion me të cilin garantohet se shtetasi i plotëson të giitha kushtet për lirim nga shtetësia të përcaktuara në nemn 20, paragrafi l, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 dhe se do të miratohet kërkesa për lirim nga shtetësia nëse shtetasi në fjalë paraqet dëshmi për fitimin e shtetësisë se

një shteti tjetër, përkatësisht paraqet garancionin e lëshuar nga organi kompetent i shtetit tjetër se do të fitojë shtetësinë e këtij shteti nëse lirohet nga shtetësia e Republikës së Kosovës.
2. Garancioni vlen për një periudhë dy (2) vjeçare që nga dita kur i është dorëzuar shtetasit. Dispozitat për revokim të përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji zbatohen përshtatshmërisht për revoklmin e garancionit,

Humbja e shtetësisë me privim

1. Pavarësisht të drejtës së personave për shtetësi të Republikës së Kosovës sipas kreut V të këtij ligji, organi kompetent mund të privojë shtetasin e Republikës së Kosovës nga shtetësia e Republikës së Kosovës, nëse shtetasi posedon shtetësi tjetër dhe nëse men-et me veprimtari, të cilat rrezikojnë sigurinë kombëtare të Republikës së Kosovës. 2. Veprimtaritë5 me të cilat cenohet rëndë giguria kombëtare e Republikës së Kosovës konsiderohen në veçanti veprimtaritë vijuese:
2.1. kur shtetasi qëllimisht i është bashkuar një organizate e cila ka për qëllim rrënimin ose dëmtimin e rendit Kushtetues të Republikës së Kosovës, ose
2.2. shtetasi ndërmerr veprime të cilat kanë për qëllim rrënirnin ose dëmtimin e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës; ose
2.3. shtetasi është anëtar i shërbimit të inteligjencës ose i forcave policore të një shteti tjetër dhe për këtë nuk ka marrë pëlqimin nga organi kompetent ose nuk është i lejuar me manëveshje ndërkombëtare,
3. Vendimi për privimin nga shtetësia e Republikës së Kosovës mund të lëshohet edhe pa pjesëmarrjen e personit në f] alë në procedurë.
4. Vendimi per humbjen e shtetësisë me privim bëhet i plotfuqishëm kur vendimi i dorëzohet personit në fialë. Në rastet lair vendimi nuk mund të dorëzohet për arsye se organi kompetent nuk mund të identifikojë vendndodhjen e personit9 vendimi për humbjen e shtetësisë me privim bëhet i plotfuqishëm në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër vendimit për privim mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente sipas Ligiit për Konflikt Administrativ
Afatet për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave

Afatet për shqyrtimin e kërkesave/ankesave nga dita e parashtrimit janë si në Vljim:

1.1. Afati i shqyrtimit të kërkesave për humbje të shtetësisë me lirim është brenda nëntëdhjetë (90) ditësh;
1.2. Afati për shqyrtimin e kërkesave për fitimin dhe rifltimin e shtetësisë është bren-da njëqind e tetëdhjetë (180) ditësh;
1.3. Afati për shqyrtimin e ankesave është brenda nëntëdhjetë (90) ditësll.

Parashtrimi i kërkesave

1. Kërkesat e përcaktuara në këtë ligj i parashtrohen organit kompetent.
2. Kërkesat mund të parashtrohen edhe pranë administratës komunale ne territorin e së cilës parashtruesi e ka vendbanimin. Në këtë rast, administrata komunale ka për detyrë Cia përcj ellë organit kompetent kërkesën e parashtruar.
3. Në rast se parashtruesi e ka vendbanimin jashtë Republikës së Kosovës, kërkesa mund t'i parashtrohet përfaqësisë më të atërt diplomatike, përkatësisht

konsullore të Republikës së Kosovës në regiion. Përfaqësia diplomatike, përkatësisht konsullore ka për detyrë t' ia përcjellë organit kompetent kërkesën e parashtruar.

Registri i shtetasve

1. Organi kompetent themelon dhe mban regjistrin e shtetasve te Republikës së Kosovës.
2. Në regjistrin e shtetasve regjistrohen të giithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mënyra e fitimit të shtetësisë si dhe të gjithë shtetasit të cilët e kanë humbur dhe rifl-tuar shtetësinë e Republikës së Kosovës pëTfshirë këtu edhe mënyrën dhe arsyet për humbjen e shtetësisë.
3. Hollësitë lidhur me mbajtjen e regiisfrit të shtetësisë dhe përfshirjen e të dhënave të tjera në regiistër përcaktohen me akt nënligjor nga organi kompetent.
4. Të dhënat personale të regjistruara në registrin e shtetasve mbahen, përdoren dhe procedohen konform dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave.
5. Shëmmi apo mungesa e ernrit në regjistër nuk është dëshmi e shtetësisë (shih nenin 29të këtij ligii) apo mungesës së shtetësisë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Organi kompetent mund t'ia përcjellë një shteti tjetër statusin e shtetësisë të një shtetasi të Republikës së Kosovës të registruar në regjistrin e shtetasve nëse plotëso-hen kushtet vijuese:

1.1. të dhënat kërkohen nga organi i shtetit tjetër që është kompetent pëT punë të shtetësisë dhe të dhënat i përcillen vetëm këtij organi;

1.2. organi kompetent i shtetit tjetër kërkon statusin e shtetësisë të shtetasit të Repub-likës së Kosovës pëT qëllime përkitazi me ITegullimin e shtetësisë, për ndonjë çështje tjetër ku vënia në dispozicion e të dhënave është pa dyshim në favor të personit me të dhënat e të cilit kërkohen dhe

1.3. shteti, organi i të cilit kërkon statusin e shtetësisë dhe shtetet ku përdoren këto të dhëna, garanton mbrojtjen e statusit të shtetësisë edhe për shtetasit e huaj.

Dëshmia e shtetësisë

Shtetësia e Republikës së Kosovës dëshmohet me certifikatën e lindjes, ekstraktin e lindjes, certifikatën e shtetësisë, Ietërnjoftimin ose me pasaportën e Republikës së Kosovës.

Taksat administrative

1. Taksa administrative caktohet me vendim nga mini stri.
2. Në përcaktimin e taksave administrative për kategorinë e personave me status refugjati apo personat pa shtetësi të merret në konsideratë neni 14 i këtij ligjl
3. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të përcaktojë me akt nënligjor kategoritë e personave të cilët për arsye sociale ose ekonomike lirohen nga detyrimi për pagesën e taksës administrative.

Statusi i banorëve tëpërhershëm të Republikës së Kosovës

1. Çdo person i cili është i regiistruar si banor i përhershëm i Republikës së Kosovës konform Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/13 për Regiistrin Qendror Civil konsiderohet shtetas i Republikës sä Kosovës dhe regiistrohet si i tillë në regjistrin e shtetasve.
2. Organi kompetent mund të verifikoj ligjshmërinë e regiistrimit të një personi si banor i përhershëm i Republikës së Kosovës. Në rast të kongtatimit se personi nuk i ka plotësuar kushtet ligiere për regiistnm si banor i Republikës së Kosovës, personi në fialë e humb cilësinë e shtetasit të Republikës se Kosovës dhe do të fshihet nga regjistri i shtetasve.
3. Humbja e shtetësisë së Republikës së Kosovës sipas paragrafit 2. të këtij neni nuk e pengon personin në rjalë të fitojë shtetësinë e Republikës së Kosovës sipas origjinës, adoptimit, lindjes në territorin e Republikës së Kosovës ose me natyralizim konform dispozitave të këtij ligii.

Regjistrimi dhepërcaktimi i shtetësisë

1. Të Riithë personat të cilët më 1 janar 1998 kanë qenë shtetas të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe që me këtë datë e kanë pasur banimin e përhershëm në Republikën e Kosovës konsiderohen shtetas të Republikës së Kosovës dhe regjistrohen si të tillë në regjistrin e shtetasve pa marrë parasysh vendbanimin ose shtetësinë që posedojnë aktualisht,
2. Dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni vlejnë edhe për pasardhësit e drejtpërdrejtë të personave të përcaktuar në atë paragraf.
3. Regjistrimi i personave te percaktuar ne paragrafin 1 dhe 2 te ketij neni ne regjistrin e shtetasve behet me kerkese te personit qe ploteson kushtet e parapara ne kete nen.
4. Organi kompetent percakton me akt nenligjor kriteret ne baze te te cilave vertetohet posedimi i shtetesise se republikes federative te jugosllavise dhe banimi i perhershem ne republiken e kosoves me date 1 janar 1998.
5. Organi kompetent do te perdore kriteret e parapara me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/13 mbi Regjistrat Civil per te percaktuar vendbanimin ne Republiken e Kosoves me 1 janar 1998.

ECMI Kosovo Contact Details

Rr. Zahir Pajaziti Nr.20 Apt.5
10000 Prishtinë/Priština, Kosovo
Tel. +381 (0) 38 224 473

Rr. Kralja Petra I 183a,
38220 Mitrovica/Mitrovicë North, Kosovo
Tel. +381 (0) 433 10 40

info@ecmikosova.org
ecmikosova.org

Find Us Online

Implemented by:

EUROPEAN CENTRE
FOR MINORITY
ISSUES KOSOVO

Financed by:

Norwegian Embassy